




SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "Abdyl Ramaj"



Në bazë të Nenit 11 të UA Nr. 02/2016, Drejtoria e shkollës bën këtë:



FTESË PËR OFERTË

Pas vendimit të marrë nga Këshilli Drejtues i shkollës, ftojmë të gjitha agjensitë turistike të marrin pjesë për ofertë për projektin shkollor "Ekskursioni i maturantëve, Tetor / 2019" të SHMP „Abdyl Ramaj” në Shirokë- Suharekë.

Ekskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë prej datës 17 Tetor deri 21 Tetor/2019.

Kohëzgjatja e e ekskursionit është 4 (katër) ditë me pansion të plota.

Në ekskursion do të marrin pjesë 200 nxënës dhe 13 nga stafi i shkollës. Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit (mëngjesi + dreka + darka), transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe kala, që parashihen në rrugëtimin e përcaktuar nga Këshilli Drejtues i shkollës.

Agjencionet turistike që marrin pjesë në ofertën e SHMP "Abdyl Ramaj" Shirokë – Suharekë për projektin shkollor " Ekskursioni i maturantëve Tetor/ 2019" duhet të plotësojnë këto parakushte:

1. Licenca "D" – fotokopje ,
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit - fotokopje,
3. Vërtetimi i pagesës së taksave komunale për biznes – fotokopje,
4. Vërtetimi nga ATK që biznesi nuk ka borgje.

Faqe 1 nga 2

Adresa: SHMP "Abdyl Ramaj", Zona industriale-Shirokë, 23000 Suharekë, Kosovë

5. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore, të bashkangjiten dëshmitë fotokopje për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion. Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
6. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për realizimin e ekskursionit.
7. Duhet të ofrojë dëshmi me shkrim për akomodimin në Hotel në të cilin plotësohen kërkesat të Këshillit Drejtues të shkollës, Këshillit të prindërve dhe Këshillit të nxënësve, sipas itinerarit të ekskursionit të përpiluar nga KDSH.
8. Duhet të ketë licencën e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit).
9. Duhet të ketë licencën e agjencionit të akreditimeve për sallën ku do të realizohen aktivitetet e lira të nxënësve (salla duhet të ketë zërim dhe klimatizim dhe pa pije alkoolike).
10. Për shoferët angazhuar në ekskursion nga agjencioni duhet ti kenë certifikatët e mjekut,CPC.
11. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatje së tij .Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës e mjekut dhe fotokopja e kontratës me të,për përkujdesje gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit.
12. Akomodimi i nxënësve të bëhet në Hotelin i cili ka sigurim fizik profesional .
13. Afati i konkurimit 7 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
14. Menynë e ushqimit për mëngjes , drekë dhe darkë e vërtetuar nga pronari i hotelit.
15. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të mënjanojë shpejtë prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose nëse është e nevojshme pa vonesë ta zëvendëson atë.
16. Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
17. Dokumentet jokomplete nuk shqyrtohen,

Përparësi në përzgjedhje do të kenë Operatorët ekonomikë, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e lartëshënuara .

Dorëzimi i ofertave bëhet deri më 09.10.2019 në ora 12.00 në zyrën pritëse të Komunës për DKA – SHMP “ Abdyl Ramaj “ në Shirokë.

Hapja e ofertave bëhet më datë 09.10.2019 në ora 14.00 në SHMP “ Abdyl Ramaj” në Shirokë .

- Formulari i paraqitjes së Ofertës dhe rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli i shkollës merren në SHMP “ Abdyl Ramaj “ në Shirokë në zyrën e Sekretarit nga data 02.10.2019.



Drejtori

Ramë Morina

Faqe 2 nga 2

Adresa: SHMP “Abdyl Ramaj”, Zona industriale-Shirokë, 23000 Suharekë, Kosovë